



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INDUSTRIË, NDERMARRËSISË, TREGTISË DHE INOVACIONIT	
MINISTARSTVO INDUSTRIJE, PREDUZETNIŠTVA, TRGOVINE I INOVACIJA	
MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP, TRADE AND INNOVATION	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	01
Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	2492
Datë: Datum: Date:	04.06.2026
PRISHTINË/A	

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva, Trgovine i Inovacija
Ministry Industry, Entrepreneurship, Trade and Innovation

Kabineti i Ministres – Kabinet Ministra – Cabinet of the Minister

Ref. Nr. 01/91
Datë: 04.06.2026

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 92 paragrafit 4 dhe nenit 93 paragrafit 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9, nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11, të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), nenit 11 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5, neneve 30 dhe 31 të Ligjit nr. 08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 28, paragrafit 1, paragrafit 6, nën paragrafit 6.1 dhe paragrafit 10 të Ligjit Nr. 04/L-240 për Masat Antidamping dhe Masat Kundërbalancuese, si dhe nenit 20 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2026 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, nxjerr:

VENDIM

Për fillimin e hetimit zyrtar lidhur me importin e farës së grurit me origjinë nga Serbia.

A r s y e t i m

Bazuar në nenin 27 të Ligjit për Masat Antidamping dhe Masat Kundërbalancuese, Departamenti i Tregtisë ka pranuar një kërkesë nga kompania prodhuese vendore e farës së grurit lidhur me dyshimet për aplikimin e çmimeve damping të farës së grurit të importuar nga Serbia, me numër tarifar 1001912000. Në përputhje me nenin 28 të këtij ligji, pas shqyrtimit të kërkesës nga Departamenti i Tregtisë dhe konsultimit me Komisionin për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe, gjetjet e analizës preliminare tregojnë se ekzistojnë indikacione se importi i këtij produkti nga Serbia, përmes shitjes me çmime damping dhe në sasi të konsiderueshme, si dhe me cilësi të dyshuar, po shkakton dëme materiale ndaj industrisë vendore të prodhimit të farës së grurit në Republikën e Kosovës. Analiza preliminare bazohet në zhvillimet e sektorit të prodhimit të farës së grurit në Kosovë, duke u mbështetur në të dhënat e siguruara gjatë hulumtimit të prodhuesit vendorë, pikat e shitjes me pakicë, të dhënat e importit nga Dogana e Kosovës, të dhënat mbi kapacitetet prodhuese dhe nevojat e tregut të siguruara nga MBPZHR, si dhe çmimet e shitjes në tregun e Serbisë.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Mimoza KUSARI-LILA

Ministre në detyrë



Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministres në detyrë;*
- *Doganës së Kosovës;*
- *Zyrë së Sekretarit të Përgjithshëm të MINTI-t;*
- *Departamentit të Tregtisë;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta të Importit;*
- *Arkivit.*